



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

**LOCAL GOVERNANCE
PROGRAM IN ALBANIA**

SUCCESS STORY

Më shumë të ardhura me anë të menaxhimit më të mirë të pronave

Katalogu i Pronave të Bashkisë është një mjet prezantues i shkëlqyer i mundësive që Bashkia e Gramshit ofron në lidhje me finalizimin e partneritetit publik-privat.



Dhurata Çima, Drejtore e Drejtorisë së Urbanistikës në Bashkinë e Gramshit, përditon të dhënat GIS me informacionin përkatës të gjendjes fizike dhe ligjore të pronave të bashkive.

Programi 4-vjeçar për Qeverisjen Vendore në Shqipëri i USAID-it, me vlerë 7.3 milionë dollarë përmirëson qeverisjen në disa bashki dhe ndërton partneritete publik-privat për të krijuar një mjedis 'miqësor për biznesin' në të cilin mund të lulëzojë sektori vendas privat. Veprimtaritë e USAID-it kanë si synim të rrisin investimet, të krijojnë vende pune me qëllimin përfundimtar rritjen e të ardhurave vendore nga taksat.

Para nëntorit të vitit 2008, Bashkia e Gramshit mernte një fitim prej 2,285,000 Lekësh, ose një vlerë prej 5.2% të ardhurash vjetore nga dhënia me qera e pronave të saj. Për më tepër, Bashkia i prezantonte pronat bashkiake tek investitorët e mundshëm vendas dhe të huaj gjatë takimeve, diskutimeve apo vizitave në terren me qëllim për t'i parë nga afër këto prona. Disa kompani shfaqën interes të veçantë për të përdorur pronat e Bashkisë së Gramshit. Por para arritjes së ndonjë marrëveshjeje, Bashkia ishte e detyruar sipas ligjit që së pari duhet të regjistronte pronat. Përveç kësaj, për treguar rëndësinë e vlerësimit të duhur të pronave të institucionit, është e nevojshme që stafi i bashkisë të jetë në gjendje të përcaktojë vlerën e pronave që administrojnë bashkia. Ky informacion ka shumë rëndësi për rritjen në maksimum të efektivitetit të përdorimit të burimeve publike. Por, fatkeqësisht, në atë kohë, stafi i bashkisë kishte informacion të pakët në lidhje me menaxhimin e pronave.

Me mbështetjen e Programit të USAID-it për Qeverisjen Vendore në Shqipëri (LGPA), janë bërë ndryshime të mëdha për stafin e Bashkisë së Gramshit. Jo vetëm që ata janë aktualisht në gjendje të vlerësojnë pronat e bashkië, por që nga nëntori i vitit 2008 ata kanë edhe katalogun e pronave bashkiake. Përveç kësaj, LGPA punoi me bashkinë e Gramshit për të krijuar burime të reja të ardhurat nga dhënia me qera apo shitja e tokave dhe ndërtesave bashkiake dhe për të përmirësuar efektivitetin dhe efikasitetin e të ardhurave dhe pronave ekzistuese nëpërmjet trainimit të stafit të Bashkisë në metodat e programit GIS për Menaxhimin e Pronave.

Dhurata Çimo, Drejtore e Drejtorisë së Urbanistikës në Bashkinë e Gramshit përshkroi ndryshimet dramatike që ka sjellë për bashkinë ky prezantim i pronave me anë të Katalogut të Pronave të Bashkisë. "Regjistrimi i pronave të bashkisë dhe botimi i të gjithë informacionit për këto prona, - tha Znj. Çimo, do të jetë me përfitim të madh për komunitetin e biznesit, sepse u jep atyre mundësinë të shohin mundësitë për investime si dhe krijojnë një mjedis miqësor për investitorët e mundshëm. Përfituesit kryesor konsiderohen komuniteti i biznesit dhe investitorët. Përveç kësaj, mjedisi miqësor për biznesin, rritja e mundësive për investime dhe transparenca do të sjellin përfitime për popullsinë vendase me anë të krijimit të vendeve të reja të punës, rritjes së nivelit të vjeljes së taksave dhe të buxhetit të bashkisë, të cilat do të rezultojnë edhe në përmirësimin e cilësisë së jetës. Po ashtu, Bashkia do të ketë burime më të mira për t'i përdorur në përmirësimin e shërbimeve publike."

"Katalogu i pronave të Bashkisë, tha Kryetari i Bashkisë së Gramshit, z. Kastriot Zera, është përpjekja e parë drejt një menaxhimi më efektiv të pronave të Bashkisë së Gramshit. Ne besojmë fuqimisht se ky botim do të jetë një mjet i pandashëm në promovimin e mundësive ekonomike vendore, në tërheqjen e investimeve vendase dhe të huaja në territorin që administrojmë dhe në gjenerimin dhe rritjen e të ardhurave vendore."

Bashkia e Gramshit është aktualisht pranë firmosjes së një marrëveshjeje me një investitor vendas që ka shfaqur interes në marrjen me qera të një prej pronave të bashkisë për të hapur një biznes rrobaqepësie në të cilin do të punësohen 200 gra nga Gramshi. "Qëllimi ynë, tha z. Zera, është të rrisin të ardhurat nga dhënia me qera e tokës dhe ndërtesave nga 5.2% në 2008 në

7% p r vitin 2009.”